



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVETKOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

KOMISIONI DISIPLINOR//DISCIPLINSKA KOMISIJA/ THE DISCIPLINARY COMMITTEE

**KD.nr.16 /2017**

KOMISIONI DISIPLINOR, në përbërje nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, kryetar, Armend Berisha dhe Gjimesh Galushi, anëtar të Komisionit, duke e shqyrtuar çështjen e përgjegjësisë disiplinore ndaj xxxxx xxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxxx, sipas raportit përfundimtar të Zyrës së Prokurorit Disiplinor ZPD-2017-049, sipas procedurës së Komisionit Disiplinor Nr. KGJK/KD/09/2017, për pretendimin për sjellje të pahijshme të përcaktuar sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 5.1.1 të Rregullores nr.04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme, në seancën dëgjimore të mbajtur në prezencën e përfaqësuesit të ZPD-së, Kadri Begolli dhe gjyqtarit xxxxx xxxxxx, me datë 24.10.2017 merr këtë:

**V E N D I M**

Xxxx xxxx, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxxx, nuk është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2, të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (Nr.03/L-223), dhe nenit 5.1.1 të Rregullores nr.04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme, siç është pretenduar në raportin përfundimtar me numër ZPD-2017-049 të Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

**A r s y e t i m**

Pranë Komisionit Disiplinor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Zyra e Prokurorit Disiplinor ka paraqitur raportin përfundimtar ZPD-2017-049, me të cilin e ka ngarkuar gjyqtarin XXxx XXXXx, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prishtinë për sjellje të pahijshme të përcaktuara sipas nenit 34 paragrafi 1 pika 1.2- neglizhencë në kryerjen, dështim për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe shkelje të nenit 5.1.1 të Rregullores nr.04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme.

Zyra e Prokurorit Disiplinor, hetimin disiplinor për sjellje të pahijshme të Gjyqtarit xxxxx xxxxx e kishte filluar sipas detyrës zyrtare me pretendim se ka neglizhuar funksionin gjyqësor, duke mos respektuar afatin ligjor për përpilimin me kohë të aktgjykimeve në këto lëndë: I.C.20/13, I.C.nr.748/13, I.C.nr.104/14, I.C.nr.263/14, I.C.nr.449/14, I.C.nr.559/14, I.C.nr.138/15, I.Cnr.240/15, I.C.nr.81/16 dhe I.C.nr. 512/16. Pranë të cilit raport në tërësi ka qëndruar përfaqësuesi i ZPD duke deklaruar se pas zhvillimit të hetimit disiplinor ZPD pretendon se ka

siguruar prova të pa kontestueshme për të argumentuar se xxxxx xxxxxx, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxx, ka kryer sjellje te pahijshme, duke neglizhuar funksionin gjyqësor.

Theksoj se në kontinuitet dhe me shpeshtësi, duke mos respektuar dispozitën e nenit 153.1 dhe 153.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që përcakton që Gjykata e jep aktgjykimin më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor: (1.1) në lëndën I.C.nr.20/2013 e ka përpilon aktgjykimin me vonesë prej 65 ditë, (1.2) në lëndën I.C.nr.104/2014 e përpilon aktgjykimin me vonës prej 39 ditë, (1.3) në lëndën I.C.nr.263/2014 e përpilon aktgjykimin me vonesë prej 44 ditë, (1.4) në lëndën I.C.nr.449/2014 e përpilon aktgjykimin me vonesë prej 44 ditë, (1.5) në lëndën I.C.nr.138/2015 e përpilon aktgjykimin me vonës prej 54 ditë, (1.6), në lëndën I.C.nr.240/15 e përpilon aktgjykimin me vonesë prej 81 ditë, (1.7) në lëndën I.C.81/16 e përpilon aktgjykimin me vonës prej 26 ditë dhe (1.8) në lëndën I.C.nr.512/16 e përpilon aktgjykimin me vonesë prej 26 ditë.<sup>1</sup>

Në lëndën I.C.nr.559/14, Gjyqtari xxxxxx e vendos me vonesë prej 23 muaj llogaritur prej datës së pranimit të lëndës në punë edhe pse lënda për nga natyra urgjente, si kontest tregtar, dhe më këtë vonesë ka kryer sjellje te pahijshme të parapara në nenin 34/1.2 të LKGJK-neglizhencë në kryerjen e funksionit gjyqësor, sjellje kjo e kategorizuar si shkelje e rëndë me nenin 5.1.1 të Rregullores 04/2016 Për Përcaktimin e Sjellje të Pahijshme dhe shkelje e kodit të zbatueshëm të etikës nga neni 34/1.4 të LKGJK.

Lidhur me pretendimet për shkelje procedurale të bëra gjatë procedimit të lëndës I.C.nr.748/13, nisur nga faktet dhe analizat e tyre, e sjellin ZPD në përfundim se sjellja duhet të vlerësohet si problem i performancës dhe nuk përbën shkelje disiplinore. Gjetjet nga ky raport, lidhur me pikën 10.1 (c) do t ia adresoj Njesisë për Shqyrtimin e Performances së Gjyqtareve.

Në seancën dëgjimore të Komisionit të mbajtur me datë 24.10.2017, ZPD e ka mbështetur në tërësi raportin përfundimtar me numër ZPD-2017-049 dhe ka kërkuar nga Komisioni inicimin e procedurës disiplinore.

Gjyqtari xxxxxxxx në seancën dëgjimore të Komisionit Disiplinor, deklaroj se ka përgatitur një parashtrësë, që ja ka dërguar disa ditë para mbajtjes së seancës dëgjimore Komisionit dhe ZPD-së, ku paraqitur opinionin dhe pretendimet e tija lidhur me këtë rast disiplinor. Theksoj se mbetet para të gjithë argumenteve që i ka paraqitur në parashtrësë, ka propozuar shume prova dhe ja lë në vlerësim Komisionit sa i sheh si të nevojshme me i marrë ato prova.

Në parashtrësën e dërguar te Komisioni dhe ZPD, gjyqtari xxxxx i propozon Komisionit që vonesat e shkaktuara ti konsideroj si të arsyeshme dhe të shkurtëra, që nuk kanë pasur ndonjë efekt dëmtues apo negativ për palët në procedurë në kontestin e përgjithshëm të procesi gjyqësor efektiv. Opinionin e tij e mbështet në parashtrimet si në vijim:

---

1

1. Lëndët që janë objekt i procedimit disiplinore, e kanë zënë ritmin normal të përfundimit, në krahasim me lëndët tjera të përpunuara nga koleget e tij gjyqtar të Departamentit Ekonomik. Në lëndët që janë objekt i procedimit, në fakt ka ndodhur që faza e procedimit me lëndët, zhvillimi i seancave ka funksionuar mire, ashtu që kanë rezultuar shumë lëndë të gatshme për të punuar aktgjykimin. Nëse shikohet në kuptimin e ngushtë të fjalës, vërtet ka pasur disa vonesa të vogla në pjesën e hartimit të vendimeve, por në kontestin e përgjithshëm të zhvillimit të procedurës, lëndët nuk janë vonuar, pra sipas gjyqtarit ka prodhuar më shumë lëndë se sa ka pasur kapacitet të hartoj vendimet.

2. Asnjë palë nuk është ankuar për çështjet e vonesës së përpilimit të aktgjykimeve. Arsyeja është se asnjë palë nuk i intereson një apo dy muaj në kontestin e një zhvillimit të një procedure gjyqësore, ku një rast gjyqësor zakonisht shkon nëpër tri nivel gjyqësore.

3. Ngarkesa me lëndë, gjatë vitit 2016 gjyqtari në parashtresë ka shënuar se ka qenë i ngarkuar me 300 lëndë Ekonomike Kontestimore, ku përfshihen edhe lëndët me inversitor të huaj, rreth 1000 lëndë ekonomike Përmbartimore (EP) dhe 4 lëndë Ekonomik të falimentimit.

4. Lëndët kanë qenë të natyrës Ekonomike Kontestimore mjaft komplekse, ku është dashur të punohen lëndët dhe të draftohen vendimet me shumë kujdes. Lënda C.nr.20/13, objekt kontesti ka pasur kërkesat që rridhnin nga një furnizim me produkte medicinale nga firma e huaj për një firmë kosovare, në një periudhë të gjatë kohore, gjegjësisht në vitet 2005-2012, vlera e kontestit ka qenë rreth 650.000. Ka mbajtur disa seanca dëgjimore, ka nxjerr ekspertiza dhe në fund ka përpunuar aktgjykimin me volum me 9 faqe. Ky aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme me revizion. Lënda C.nr.104/14, është me një paditës dhe me tri palë të paditura dhe se është punuar në një vëllim prej 7 faqesh aktgjykim, që sigurisht e dëshmon kompleksitetin e lëndës. Lënda C.nr.138/15, me vlerë kontesti prej 600.00.00€, ishte po ashtu e ndërlikuar. Lënda C.nr.263/14, me vlerë kontesti prej 3,875,450.00, po ashtu ishte e ndërlikuar.

Ka theksuar se ka pasur edhe angazhime shtesë si Gjyqtar Përgjegjës i Departamentit Ekonomik, ka qenë gjyqtar i vetëm për investime të huaja. Një pjesë të kohës është marrë edhe me lëndët e falimentimit dhe deri me tani ka përfunduar 4 lëndë të falimentimit.

Sipas gjyqtarit xxxxxx lëndët që janë objekt i procedimit disiplinor nuk kanë qenë të natyrës urgjente apo me prioritet në gjykim siç pretendon ZPD. Në sistemet e avancuara gjyqësore, zhvillohen politika të veçanta, krijohen mbështetje shtesë me gjyqtarë dhe staf mbështetës për gjykata/departamente ku gjykohen lëndë të natyrës ekonomike. Kontestet tregtare shpesh herë janë me vlera të mëdha financiare dhe nëse shikohet si urgjente, gabimet do të jenë fatale.

Gjatë kësaj periudhe gjyqtari ka deklaruar se ka pasur disa probleme shëndetësore, dhe se këto probleme shëndetësore i kanë zgjatur 3-4 muaj.

Vonesat në hartimin e aktgjykimeve kanë qenë të shkurtra dhe nuk duhen të trajtohen si shkelje e etikes. Raporti i ZPD-së nuk ka marrë për bazë faktin që është praktik e rregullt në Departamentin Ekonomik, që fjala përfundimtare dorëzohet me shkrim nga pala në procedurë, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor, në një afat që zakonisht është 7, 10 deri në 15 ditë, varësisht prej kompleksitetit të lëndës.

Zyra e Prokurorit Disiplinor në fjalën përfundimtare deklaroj se provat që i kanë administruar dhe janë në raportin e ZPD-së, janë të mjaftueshme, për të ardhur në përfundim se gjyqtari ka kryer sjellje të pa hijshme dhe atë neglizhencë, në ushtrimin e funksioni gjyqësor. Ka theksuar se ZPD ka parasysh se ka vonesat në të gjitha Gjykatat, të shumë gjyqtar në vonesat e përpilimit të aktgjykimit. Duke u nisur nga kjo situatë edhe ligjvënësi ka krijuar një ventil dalës që gjyqtari të mbrohet prej pasojave të mundshme disiplinore për shkak të mos përmbajtjes së dispozitës së neni 153 i cili është shumë strikt dhe përcakton afat ligjor. Nuk është në pyetje afati administrativ, po është fjala për afat ligjor, të cilin ne duhet me e respektuar. Në të kundërtën, mundet me ardh deri të një pasoj disiplinore, ose në variantin me të mire e shfrytëzon mundësin, e njofton kryetarin e Gjykatës. Kjo në këtë rast nuk ka ndodhur. Situata e dytë ka të bëjë se këto vonesa nuk janë vonesa të izoluara, por janë vonesa që kanë ndodhur në kontinuitet. Fakti është që në këto raste, ZPD-ja i ka shqyrtuar dhe kanë gjetur vonesa, që trajtohen si sjellje të pahijshme. Në kontinuitetit e vonesave është irelevante fakti se në një rast kemi të bëjmë 15 ditësh, në një rast 32, ose rasti tjetër prej 68 ditësh. Secila këto raste në mënyrë individuale dhe po të kish qenë e vetme, nuk kish me qenë objekt i sjellje se pahijshme, por në kontinuitet kur të merret, krijon brumin që të trajtohet si sjellje e pahijshme. Bashkëpunimi me gjyqtarin ka qenë shumë korrekt dhe profesional dhe është hera e parë që gjyqtari është në këtë situatë, që të jap përgjigjeje para Komisioni Disiplinor. Kërkoj nga Komisioni Disiplinor që raporti të aprovet si i tillë dhe gjyqtari të shqiptohet sanksionin disiplinor në përputhe me gjetjen e sjellës se pahijshme nga ana e Komisioni Disiplinor.

Gjyqtarin xxxxx në fjalën përfundimtare deklaroj se duke u bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat e lartcekura, para Komisionit Disiplinor nuk ndihem përgjegjës për ndonjë shkelje disiplinore, pasi që secilën lëndë e kam punuar me ndërgjegjen dhe përgjegjësinë më të madhe. Në kuptimin e përgjithshëm, lëndët nuk janë vonuar, e posaçërisht nëse krahasohen me lëndët e tjera në Departament që në të njëjtën kohë janë deponuar në gjykatë (*e që shumë prej tyre janë ende në punë*). Kam pasur disa vonesa të vogla në lëshimin e vendimeve, që ZPD-ja nuk i ka llogaritur në mënyrë të saktë, por në dëmin tim. Sidoqoftë, ato vonesa mjaftë të shkurtra, besoj fuqishëm se kanë qenë të arsyeshme, dhe shpresoj se ky Komision do të më pranoj arsyet që kam dhënë në këtë parashtrësë, dhe do të më shpallë jo përgjegjës për shkeljet disiplinore të pretenduara.

Komisioni Disiplinor i administroj të gjitha provave në shkresat e lëndës, provat shtesë të gjyqtarit xxxxx xxxxx dërguar Komisionit dhe ZPD-së, ka dëgjuar edhe deklarata e gjyqtarit dhe përfaqësuesit të ZPD të dhënë gjatë seancës dëgjimore, dhe pasi i ka shqyrtuar dhe analizuar, konstatoj se gjyqtari xxxxx xxxxx në rrethanat e lartpërmendura nuk është përgjegjës për sjellje të pahijshme të pretenduara nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, nuk ka neglizhuar në kryerjen dështim për të kryer apo abuzim të funksioneve gjyqësore, dhe nuk ka shkelur nenin 5.1.1 të Rregullores nr.04/2016 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme.

Është e vërtet se në Rregulloren për Përcaktimin e Sjelljeve të pahijshme nr.04/2016, parashihet si shkelje e rendë vonesa e pa arsyeshme e përpilimit të aktgjykimit, në rastet konkrete kontestuese dhe të pretenduara nga ZPD, ekzistojnë vonesa ditore dhe të arsyetuara nga ana e Gjyqtarit xxxxxx. Duke i marrë parasysh faktet që i ka paraqitur gjyqtari xxxxxx, ku ka argumentuar shumë qartë dhe arsyetuar faktet se pse është vonuar: një periudhë kohore ka qenë i sëmur, përafërsisht 3-4 muaj, lëndët konkrete kontestuese kanë pasur të bëjnë më çështje shumë komplekse, mandej gjyqtari xxxxx ka angazhime gjyqësore shtesë, është edhe përgjegjës për Departamentin Ekonomik, ku i është dashur që ti koordinoj punët me gjyqtaret e departamentit ekonomik, me kryetarin e Gjykatës, dhe me institucionet tjera, si përgjegjës i këtij departamenti. Gjyqtari ka prezantuar para Komisionit me prova dhe dëshmi edhe mbingarkesën e madhe me lëndë .

Edhe pse ekzistojnë provat për vonesa të shkurtëra, duke ju referuar të lartcekura dhe duke pasur parasysh faktin se përfaqësuesi i ZPD-së nuk ka arritur të argumentoj kundërshtimet e gjyqtarit xxxxxx, kur ju referua se e kanë llogaritur si kohë vonesë edhe atë kohë që gjyqtaret në praktik ju japin palëve për hartimin e fjalës përfundimtare, edhe pse ka përfunduar shqyrtimi kryesor. Në praktik palët kërkojnë afat për ta shkruar fjalën përfundimtare dhe se ai afat ka mundur të jetë deri në 15 ditë. Sikur të ishte llogaritur nga Zyra e Prokurorit Disiplinor edhe kjo situatë, sigurisht që kishte me ndryshuar edhe gjendja e afateve sa i përket vonesës së hartimit të këtyre aktgjykimeve, dhe se vonesat kishin me qenë me të shkurtra nga ato të konstatuara në raport.

Në rrethana të lartpërmendura, Komisioni konsideron që vonesat që janë bërë nga ana e gjyqtarit xxxxx janë vonesa të arsyetuara, pra nuk hyjnë në sferën e dëmit të madh, që të trajtoheshin si vonesa të pa arsyeshme.

Ndërsa sa i përket dy pikave tjerë që ZPD i ka paraqit në raport përfundimtar, Komisioni konsideron se procedimi i një lënde respektivisht procedura e cila zhvillohet rreth një lënde të caktuar, veprimet procedurale që ndërmerren në një lëndë nuk hynë në fushën disiplinore gjithashtu dërgimi i ftesave ka të bëjë me veprime procedurale e jo disiplinore e që sipas komisionit këto çështje trajtohen nga gjykata e shkallës së dytë, nga ana tjetër ka të bëjë me çështjen e performancës së një gjyqtari në rastin konkret të gjyqtarit xxxxx xxxxxx.

Komisioni konstaton se gjyqtari xxxxxx xxxxxx nuk ka kurrfarë përgjegjësie disiplinore siç ka pretenduar në raportin përfundimtar ZPD-2017-049 Zyra e Prokurorit Disiplinor, vlerëson se në këtë rast gjyqtari xxxxxx nuk ka kryer sjellje të pahijshme siç pretendon ZPD dhe nuk është involvuar me ndonjë veprim konkret që do të rezultonte me shkelje të standardeve të sjelljeve profesionale për gjyqtarë.

Prandaj, Komisioni ka konstatuar se gjyqtari xxxxx xxxxx nuk është përgjegjëse për sjellje të pahijshme të parapara me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1, pika 1.2, dhe nenin 5.1.1 të Rregullores 4/16 për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme.

Nga se u tha më lartë vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR**  
**KD.nr.16/2017, datë 24.10.2017**

Kryetar i Komisionit Disiplinor  
Gjyqtari, Skender Çoçaj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në Prishtinë, brenda 15- ditësh nga dita e pranimet të Vendimit.

Vendimi t'u dërgohet:

- Nehat Idrizi, kryesues i KGJK-ës;
- Zef Prendrecaj, drejtor, Zyra e Prokurorit Disiplinor;
- Xxxxx xxxxx, kryetare në Gjykatën Themelore në xxxxxx;
- Xxxxx xxxxx, gjyqtar në Gjykatën Themelore në xxxxxxx;
- Departamentit të Administratës dhe Personelit në SKGJK;